

A mjekohet sëmundja e blutongut (gjuha blu) dhe cfarë duhet të dijë fermeri në këtë rast?

- Sëmundja Blutongut(gjuha blu) nuk ka mjekim specifik.
Therja e kafshëve të prekura nga Blutongu(gjuha blu) nuk është produktive.
Nuk ndikon në uljen e infeksionit.

Trajtimi i të sëmurave është një masë për minimizimime dëmtimeve. Për këtë fermeri duhet të dije(të jetë i ndërgjegjshëm) se trajtimi i kafshëve të sëmura është e vetmja mënyrë për të ulur maksimalisht dëmtimet, kur kjo sëmundje vërehet në tufë. Për këtë, është e domosdoshme, që me tu shfaqur shënjat e para të dyshimta të kësaj sëmundjeje (të cilat i përmëndëm më lartë), fermeri duhet të njoftojë mjekun veteriner më të afërt, shtetëror apo privat.

Në rastin kur ky i fundit shkon në tufë dhe dyshon për këtë sëmundje, është i detyruar që të njoftojë shërbimin veterinar shtetëror. Kontrolli i menjhershëm i tufës, evidentimi i kafshëve të sëmura dhe veçimi i tyre është masa e parë e domosdoshme e mbrojtjes. Kjo duhet të bëhet çdo ditë. Me të njëjtin kujdes, deri sa në tufë të mos ketë më raste me shënja të tilla të dyshimta. Kafshët është mirë që të izoloohen në një vend të veçantë. Vendi duhet të ketë një shtresë kashte mjaft të trashë që ato(kafshët) të mos jenë të detyruara, që nga dhëmbjet e gjymtyrëve të rinë vazhdimisht ulur. Thëksojmë se kafshët me leziona në gjymtyrë, kanë dhëmbje të mëdha. Tek kafshët

e izoluara duhet gjithashtu të përdoren preparate të ndryshme kundër mushkonjave(spray) si dhe menjëherë fillon trajtimi medikamentoz i tyre i cili përfshin përdorimin e solucionëve të glukozës dhe ata fiziologjikë. Përdorimi i preparateve antibiotikë, për të penguar aktivizimin e mikroorganizmave dytësorë. **Kujdes,nuk duhet abuzuar me këtë rast me antibiotikët.** Krahësimisht trajtohen plagët në gojë, hundë si dhe në gjymtyrët. Përdorimi i preparateve anti-inflamatorë **jo kortizonikë**, ndihmon në uljen e edemave. Po kështu përdoren dhe preparatet antipiretikë si dhe kundër dhëmbjeve. Përdorimi i vitaminave është një element thelbësor në këtë drejtim. **Fermerë kujdes: mos fusni kafshë të pa infektuara në tufën që dyshoni për**



Dr Lazim Zurapi,
Tetovë, Shtator 2014

prezencën e infeksionit. Tufat nuk duhet të lëvizin nga zonat ku janë si dhe duhet të evitohet në maksimum kontakti me tufat e tjera të infektuara ose jo. Kafshët e vdekura nuk duhet të hidhen andej këtej por të groposen në bazë të ligjit të shërbimit veterinar. Kush bën të kundërtën duhet të mbajë përgjegjësi për përhapjen e infeksionit me dashje. Stallat ku qëndrojnë dhëntë (si ato të sëmura dhe ato pa shënja klinike) duhet të pastrohen dhe dezinfektohen me preparate anti mushkonja. Është mirë që tufa/at të mos lejojnë të kullosin në pikun e aktivitetit të mushkonjave, pra nga ora 10 deri në orën 16. Ato të kullosin herët në mëngjes dhe vonë në darkë, duke eliminuar kështu sa më shumë të jetë e mundur kontaktin me mushkonjat. Është e rekomandueshme që zona rreth stallave të dezinfektohet me preparate anti mushkonja. Lënia e pellgjeve me ujë, apo lagështirave afër stallave, krijon ambiente të përshtatshme për shtimin e mushkonjave, po kështu dhe grumbuj e plehut apo mbeturinave të tjera. Instrumentat që përdoren për kafshët e infektuara me Blutong(gjuha blu) duhet ose të groposen, ose të sterilizohen, përpara se të përdoren për kafshët e tjera. Përdorimi i preparative kundra mushkonjave, individualisht apo dhe si grup në momentin që kafshët futen në stallën është moment tepër i rëndësishëm.

A mund të kontrollohet sëmundja e Blutongut (gjuha blu)?

Si sëmundje e listës së OIE, kjo sëmundje i nënshtrohet rregullave ndërkombëtare të kontrollit. Ndonëse është e vështirë të kontrollohet plotësisht sëmundja, ekzistojnë disa mënyra për minimizimin e humbjeve ekonomike. Përpjekjet për të kontrolluar sëmundjen e gjuhës blu bazohen në disa drejtime si lufta kundër vektorit, higjena sanitaro veterinare etj. Reduktimi i shkallës së infeksionit tek vektori transmetues është masë e rëndësishme, por nuk mund të garantohet 100% mbrojtja nga vektori e kafshëve. Popullatat e mushkonjave vektorë mund të reduktohet nga përdorimi i insekticideve larvicidë me bazë (Deltamethrinën) në vendin e shumëzimit të tyre sidomos në vend qëndrimet e tyre afër stallave. Dezinfektimi i gjithë ambientit përreth stallave nuk është shumë produktiv. Preparatet insekticidë mund të aplikohen edhe direkt tek kafshët apo dhe në mjediset ku rrinë kafshët. Ato duhet të përdoren herë mbas here, pasi deri tani nuk ka asnjë preparat që të ketë efekt për një kohë të gjatë. Maksimumi i efektit të tyre zgjat 1-2 ditë. Pastrimi i vazhdueshëm i stallave, heqja e plehut, përpunimin termik dhe dezinfektimin e tij janë elementë që ndikojnë dukshëm në uljen e nivelit të mushkonjave. Pastrimi i ambientit përreth stallave dhe gryerja në një thellësi 6-10 cm, është mjaft produktive , pasi ky është vendi ideal ku rinë shumica e larvave të mushkonjave. Përdorimi i ivomekut në gjedhë ka efekt insekticid në mushkonjat që pickojnë gjedhin në stadin viremik, si dhe efekte larvicide në feçet (feçet janë mjaft atraktive për

mushkonjat) e kafshëve. Krahas kësaj, sëmundja e bën të detyrueshme kontrollin e lëvizjes së kafshëve, pasi kafshët e infektuara mbeten infektive për një periudhë nga 30-60 ditë, madje një pjesë e tyre më gjatë. Mbajtja e tufave të deleve larg tufave të gjedhit përbën një masë efikase kontrolli jo vetëm për këtë infeksion, por edhe për ethen katarale malinje të gjedhit e cila gjithashtu qarkullon sporadikisht në vendin tonë. Tek kafshët, sëmundja mund të kontrollohet edhe me përdorimin e vaksinave. Vaksinat janë të gjalla të atenuara dhe të vdekura (inaktivuara). Vaksinat e gjalla nuk duhet të përdoren në rastin e një forme epidemie të infeksionit siç është rasti jonë aktualisht, virusi që gjëndet në këtë vaksinë, krijon bashkime me virusin që qarkullon tek mushkonjat dhe kafshët duke shkaktuar krijimin e virusëve të rinj dhe mjaft patogjenë. Përdorimi i vaksinave të inaktivuara rekomandohet aktualisht nga disa vënde, porse ato janë me kosto për shkak të përdorimit dy herë të tyre. Theksojmë përsëri se: Kontrolli i sëmundjes nëpërmjet therjeve të kafshëve të prekura, nuk duhet të jetë pjesë e strategjisë së luftimit të kësaj sëmundjeje.

A lejohet përdorimi i mishit të kafshëve të infektuara?

Sëmundja e Blutongut (gjuha blu) NUK ËSHTË ZOONOZË. Për këtë arsye, mishi i kafshëve të prekura nga kjo sëmundje, përdoret pa kufizim. Nuk lejohen për konsum kafshët të cilat, si pasojë e sëmundjes, janë kashektike, kanë dekubituse (plagë nga qëndrimi shtrirë), janë trajtuar me antibiotikë në momentin e fundit, ato që theren në agoni etj. Të gjitha kafshët e tjera nuk përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut.

Prof. Dr. Kristaq BËRXHOLI
Fakulteti i Mjekësisë Veterinare
Departamenti i Shëndetit Publik Veterinar
Tiranë